



**KPM-2018/01**

Në mbështetje të nenit 3, paragrafi 2, nënparagrafi 2.6 dhe 2.11, të Ligjit Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, KPM miraton këtë:

**DRAFT RREGULLORE PËR MBËSHTETJEN E OFRUESVE TË  
SHËRBIMEVE MEDIALE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE ME MBULIM  
TOKËSOR LOKAL DHE REGJIONAL**

**NENI 1  
QËLLIMI**

Kjo Rregullore përcakton kushtet, kriteret dhe procedurën për ndarjen e mjeteve nga Fondi i KPM-së dhe mënyrën se si duhet të përdoren këto mjete. Qëllimi i ndarjes së mjeteve nga Fondi i KPM-së është që t'u ofrohet mbështetje ofruesve të shërbimeve mediale me qëllim të promovimit të programeve cilësore të shumëllojshme në interes të publikut.

**NENI 2  
FUSHËVEPRIMI**

Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen ndaj të gjithë të licencuarve të KPM-së të cilët ushtrojnë aktivitete të ofrimit të shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale me mbulim tokësor lokal dhe regional në Republikën e Kosovës.

**NENI 3  
PËRKUFIZIMET**

- Ofrues i shërbimit medial audiovizual (OSHMA)** – personi fizik ose juridik i cili ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audiovizuale të ofruesit të shërbimit medial dhe përcaktimin e mënyrës së organizimit të tij.
- Fondi për Mbështetje-** (në tekstin e mëtejshëm: Fondi) është shuma e mjeteve e grumbulluar nga të hyrat nga tarifa vjetore e licencës dhe donacione tjera të dedikuara për mbështetje në formë të granteve për OSHMA-të.

3. **Grant Programor** - Mbështetja financiare për një projekt me aktivitete specifike programore, të detajuara në aplikacionin për grant, me rezultate të matshme përfundimtare.
4. **Aplikacioni për Grant** - Formulari në formë pyetësi i dedikuar për plotësim me informata relevante rreth projekt propozimit për të cilin kërkohet mbështetja financiare.
5. **Përfitues i Grantit**- i licencuari i cili i përmbush kriteret për financim të projektit dhe nënshkruan kontratën për financim me KPM-në.
6. **I Licencuar** - personi juridik të cilit KPM-ja i ka dhënë Licencën për të operuar si ofrues i shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale.
7. **Parashtruesi i kërkesës** – i licencuari i KPM-së, me mbulim tokësor lokal dhe regjional, që aplikon për grant programor.
8. **Komisioni Vlerësues** – komisioni i caktuar nga KPM për vlerësim të aplikacioneve dhe përpilim të rekomandimit të listës së përfituesve të Fondit.

#### **NENI 4 SIGURIMI I TË HYRAVE**

1. Mjetet e Fondit të KPM-së sigurohen nga shuma e përgjithshme e tarifës vjetore të licencës, siç është e përcaktuar me Rregulloren përkatëse të KPM-së për nivelin e tarifës vjetore për Licencë.
2. Përqindja e shumës së përgjithshme të tarifës vjetore të licencës që do të përdoret për këtë Fond do të përcaktohet me vendim të KPM-së.
3. Ky fond mund të plotësohet me donacione dhe të interesuarit e tjerë për kontribute dhe mbështetje financiare, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

#### **NENI 5 NDARJA E FONDEVE**

1. Ndarja e mjeteve nga Fondi bëhet përmes:
  - 1.1 granteve programore për mbështetje të ofruesve të shërbimeve mediale me qëllim të promovimit të programeve cilësore të shumëllojshme në interes të publikut.
2. Ndarja e mjeteve nga Fondi bëhet në pajtim me parimet e mëposhtme:
  - 2.1 liria, profesionalizmi dhe pavarësia e OSHMA-ve;

- 2.2 ndalimi i censurës;
- 2.3 qasja e lirë dhe e barabartë në mjetet e Fondit;
- 2.4 zhvillimi i konkurrencës, pluralizmit dhe përmbajtjeve programore cilësore;
- 2.5 objektiviteti, ndalimi i diskriminimit dhe transparenca.

## **NENI 6 PROCEDURAT E APLIKIMIT**

1. Ndarja e mjeteve nga Fondi bëhet nga Komisioni i Pavarur i Mediave (në tekstin e mëtejshëm: KPM) në bazë të thirrjes publike për ndarjen e mjeteve nga Fondi i KPM-së.
2. Thirrja publike sipas paragrafit 1 të këtij neni përmban informata mbi:
  - 2.1 llojet e kategorive programore që do të mbështeten përmes mjeteve nga Fondi;
  - 2.2 shumën e mjeteve nga Fondi që do të ndahet në kuadër të thirrjes publike për lloje të caktuara të kategorive programore;
  - 2.3 fushat tematike të interesit publik të cilave u dedikohen përmbajtjet origjinale, të cilat do të financohen ose bashkë-financohen me grante programore;
  - 2.4 kriteret e përzgjedhjes dhe metodologjia e vlerësimit;
  - 2.5 kalendari i disbursimit të mjeteve të ndara në kuadër të thirrjes publike;
  - 2.6 afati i aplikimit, të paktën tridhjetë (30) ditë nga data e publikimit të thirrjes publike;
  - 2.7 afati për marrjen e vendimit, jo më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë nga skadimi i afatit të aplikimit;
  - 2.8 kriteret e tjera për aplikim në thirrjen publike.
3. Thirrja publike publikohet në ueb faqen e KPM-së.

## **NENI 7 MBËSHTETJA E PËRMBAJTJES PROGRAMORE**

1. Përmbajtja origjinale, që do të mbështetet nga grantet programore, mund t'u përkasë fushave tematike si në vijim:
  - 1.1 diversiteti kulturor dhe ruajtja e traditave;

- 1.2 përmbajtjes edukative-arsimore;
  - 1.3 përmbajtjes kushtuar fëmijëve dhe të rinjve;
  - 1.4 përmbajtjes që nxit kreativitet kulturor dhe artistik;
  - 1.5 zhvillimit të edukimit, shkencës dhe artit;
  - 1.6 mbrojtja e mjedisit dhe të konsumatorëve;
  - 1.7 shëndeti, kultura shëndetësore dhe mënyrat e shëndetshme të jetesës;
  - 1.8 mbrojtja e të drejtave dhe dinjitetit të pakicave dhe lufta kundër diskriminimit, stereotipave dhe paragjykimit;
  - 1.9 ofrimin e përmbajtjes për grupet e cenueshme shoqërore, duke përdorur teknologjitë e përshtatura për nevojat e tyre.
  - 1.10 Përmbajtje me interes të veçantë për kategori të caktuara shoqërore në regjionet përkatëse.
2. Përmbajtja sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk duhet të përmbajë komunikime komerciale audiovizuale apo çfarëdo materiali që mund të ndikojë në pavarësinë editoriale të programit.

## **NENI 8**

### **OSHMA-TË QË PËRJASHTOHEN NGA NDARJA E FONDEVE**

1. Mjetet nga Fondi nuk ndahen për përmbajtjen origjinale, kostot e së cilit ofruet të shërbimeve mediale i kanë mbuluar plotësisht përmes donacioneve, sponsorizimeve ose granteve të dhëna nga institucionet vendore dhe të huaja.
2. Përmbajtja origjinale që nuk merret parasysh për ndarje të mjeteve përfshin si në vijim:
  - 2.1 programet e të gjitha zhanreve që nuk kanë përshkrim të qartë dhe përmbajtje të përgatitur paraprakisht;
  - 2.2 transmetimi i drejtpërdrejtë ose i mëvonshëm i ngjarjeve sportive, me përjashtim të atyre për persona me aftësi të kufizuar;
  - 2.3 transmetimi i drejtpërdrejtë i paredaktuar ose i mëvonshëm i organizimeve politike ose të tjera;
  - 2.4 transmetimi i drejtpërdrejtë ose i mëvonshëm i ceremonive dhe shërbimeve fetare;
  - 2.5 programet argëtuese; dhe
  - 2.6 informimi mbi ofrimin e shërbimeve.

## **NENI 9**

### **KRITERET E PËRZGJEDHJES**

1. Kriteret përzgjedhëse të thirrjes publike janë objektive, të matshme dhe jo-diskriminuese, si dhe ndërlidhen me:

1.1 realizimin origjinal (përqindja, kompleksiteti i realizimit, tema);

1.2 numrin e të punësuarve;

1.3 kontributin ndaj përmirësimit të përzgjedhjes/ofertës së përmbajtjes programore që u dedikohet grupeve të caktuara të shoqërisë; dhe

1.4 numri i përfituesve potencial.

2. Përveç kriterëve nga paragrafi 1 i këtij neni, kriteret për ndarjen e mjeteve në kuadër të grantit programor gjithashtu mund të ndërlidhen me:

2.1 aktualitetin e çështjes në të cilën përqendrohet përmbajtja e propozuar;

2.2 realizueshmërinë dhe arsyetimin e planit të ekzekutimit dhe buxhetin e propozuar për realizimin e përmbajtjes;

2.3 përmirësimin e kulturës së dialogut shoqëror dhe politik;

2.4 mundësimin e ndërveprueshmërisë dhe pjesëmarrjes aktive të publikut;

2.5 përqindjen e vetë-financimit; dhe

2.6 përvojën paraprake në realizimin e përmbajtjes së ngjashme.

2.7 Promovimi i gjuhëve standarde zyrtare.

## **NENI 10**

### **DETYRIMET FINANCIARE**

1. Thirrja publike është e hapur për të licencuarit që i përmbushin të gjitha detyrimet financiare karshi KPM-së para se të aplikojnë në thirrjen publike.

2. Mjetet që mund t'i ndahen një ofruesi të shërbimeve mediale nga Fondi gjatë një viti nuk tejkalojnë:

2.2 30% të gjithsej të ardhurave vjetore të vitit paraprak nga shpallja e thirrjes publike, për të licencuarin me gjithsej të ardhura vjetore mbi 50.000;

- 2.3 50% e gjithsej të ardhurave vjetore të vitit paraprak nga shpallja e thirrjes publike, për të licencuarin me gjithsej të ardhura vjetore prej 10,000 deri 50,000 €;
- 2.4 70% e gjithsej të ardhurave vjetore të vitit paraprak nga shpallja e thirrjes publike, për të licencuarin me gjithsej të ardhura vjetore ndërmjet 5,000 dhe 10,000 €;
- 2.5 100% e gjithsej të ardhurave vjetore të vitit paraprak nga shpallja e thirrjes publike, për të licencuarin me gjithsej të ardhura vjetore deri në 5,000 €.
3. Pavarësisht nga paragrafi 2 i këtij neni, të dhënat nga Plani i Biznesit (projektimi tre vjeçar) mbi projektimin e të ardhurave të përgjithshme për vitin e parë, të cilat i dorëzohen KPM-së në procesin e licencimit, merren si bazë për përcaktimin e shumës më të lartë që mund të ndahet në vit për OSHMA që nuk ka pasqyrë financiare për vitin paraprak nga shpallja e thirrjes publike për shkak të datës së themelimit.

## **NENI 11**

### **APLIKIMI PËR GRANT PROGRAMOR**

1. Aplikacioni në përgjigje të thirrjes publike për ndarjen e granteve programore dorëzohet në KPM në formular të veçantë.
2. Formulari i Aplikacionit për Grant Programor përfshin:
  - 2.1 informatat kryesore për parashtruesin e kërkesës;
  - 2.2 të dhëna mbi strukturën dhe fushëveprimin e programit gjatë procedurës së thirrjes publike;
  - 2.3 të dhëna mbi përmbajtjen për të cilën dorëzohet Aplikacioni për Grant Programor;
  - 2.4 plani i realizimit të përmbajtjes; dhe
  - 2.5 të dhëna mbi strukturën e burimit financues të programit (fondet e nevojshme, fondet e siguruar nga burimet tjera, si dhe fondet të cilave u referohet aplikacioni).
3. Formulari i Aplikacionit për Grant Programore gjithashtu përmban deklaratat e parashtruesit të kërkesës të cilat vërtetojnë që:
  - 3.1 të dhënat janë të sakta; dhe
  - 3.2 nuk janë ofruar mjete nga burime të tjera që mundësojnë financim të dyfishtë.
4. Krahas Aplikacionit për Grant Programor, parashtruesi i kërkesës duhet të dorëzojë edhe:

- 4.1 Raportin Vjetor, në të cilin përfshihen informacione të detajuara në pajtim me nenin 28 të Ligjit të KPM-së;
  - 4.2 pasqyrën financiare që i është dorëzuar organit përgjegjës tatimor (ATK) për vitin paraprak nga data e shpalljes së thirrjes publike;
  - 4.3 vërtetimin nga Agjensioni për Regjistrim të Biznesit (ARBK) që dëshmon se parashtruesi i kërkesës për Grantin Programor nuk është në procedurë të falimentimit, i cili nuk duhet të jetë më i vjetër se 30 ditë nga data e shpalljes së thirrjes publike;
  - 4.4 vërtetimin nga Agjensioni për Regjistrim të Biznesit (ARBK) që dëshmon se parashtruesi i kërkesës për Grantin Programor nuk është në procedurë të likuidimit, i cili nuk duhet të jetë më i vjetër se 30 ditë nga data e shpalljes së thirrjes publike;
  - 4.5 vërtetimin nga Banka Qendrore e Kosovës (BQK) që dëshmon se llogaritë e parashtruesit të kërkesës për Grantin Programor nuk janë të ngrira si rezultat i inkasimit të detyruar, i cili nuk duhet të jetë më i vjetër se 30 ditë nga data e shpalljes së thirrjes publike;
  - 4.6 organogramin dhe klasifikimin e vendeve të punës në strukturën organizative;
  - 4.7 buxhetin e propozuar, i dorëzuar me formular të veçantë, i cili është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.
5. Për çdo përmbajtje, parashtruesi i kërkesës për Grantin Programor duhet të dorëzojë:
- 5.1 Përshkrimin e përmbajtjes të cilës i referohet aplikacioni;
  - 5.2 Planin e realizimit të përmbajtjes;
  - 5.3 Strukturën financiare për realizimin e përmbajtjes; dhe
  - 5.4 Buxhetin për planin e realizimit të përmbajtjes.

## **NENI 12**

### **FORMA E DORËZIMIT TË APLIKACIONIT**

1. Aplikacioni, së bashku me dokumentacionin mbështetës, duhet të dorëzohet në KPM:
  - 1.1 në formë elektronike në CD; dhe
  - 1.2 në format të shtypur të lidhur në atë mënyrë që faqet të mos mund të shtohen ose hiqen pas dorëzimit të aplikacionit.

2. Parashtruesi i kërkesës mund të dorëzojë edhe dokumente tjera që konsiderohen të vlefshme për procesin e vendimmarrjes.

### **NENI 13**

#### **THEMELIMI I KOMISIONIT VLERËSUES**

1. Komisioni Vlerësues themelohet me vendim të KPM-së.
2. Me anë të këtij vendimi përcaktohet përbërja dhe detyrat e anëtarëve të Komisionit nga paragrafi 1 i këtij neni.

### **NENI 14**

#### **VLERËSIMI I APLIKACIONEVE**

1. Vlerësimi i aplikacioneve bëhet nga Komisioni Vlerësues.
2. Komisioni Vlerësues përpilon listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret për mbështetje dhe listën e aplikacioneve të refuzuara.
3. Aplikacionet do të refuzohen në rastet kur:
  - 3.1 aplikacionet në thirrjen publike janë jo të plota dhe janë dorëzuar jashtë afatit;
  - 3.2 aplikacionet e OSHMA-ve të cilave u është pezulluar përkohësisht licenca e transmetimit nga KPM-ja;
  - 3.3 aplikacionet e OSHMA-ve të cilat nuk i kanë shlyer detyrimet financiare karshi KPM-së;
  - 3.4 aplikacionet e OSHMA-ve të cilat janë në procedurë të falimentimit ose likuidimit;
  - 3.5 aplikacionet e OSHMA-ve të cilave u janë ngrirë llogaritë bankare në procedura të inkasimit të detyruar; dhe
  - 3.6 aplikacionet e OSHMA-ve të cilave u është kërkuar, si përfitues të Fondit, të kthejnë mjetet e ndara nga Fondi në kuadër të njëres prej dy thirrjeve publike paraprake, për shkak të shkeljes së kësaj Rregulloreje ose të dispozitave të kontratës për ndarjen e mjeteve nga Fondi.
4. Komisioni Vlerësues i rekomandon Komisionit të Pavarur të Mediave Listën e kandidatëve që plotësojnë kriteret për mbështetje.



**NENI 15**  
**VENDIMI PËR NDARJEN E MJETEVE**

1. Brenda nëntëdhjet (90) ditësh nga kalimi i afatit për aplikim në thirrjen publike, Komisioni i Pavarur i Mediave merr Vendimin për ndarjen e mjeteve nga Fondi në bazë të rekomandimit të listës nga Komisioni Vlerësues.
2. Në rast se buxheti i përgjithshëm i kërkuar nga aplikacionet për grante është më i madh se buxheti i paraparë nga thirrja publike, Komisioni i KPM-së iu ndan mjetet nga Fondi, në bazë të analizës krahasuese, parashtruesve të kërkesës me pikët më të larta.

**NENI 16**  
**NDARJA E MJETEVE**

1. Komisioni i KPM-së vendos mbi ndarjen e mjeteve nga Fondi me miratimin e një vendimi.
2. Komisioni i KPM-së publikon raportin mbi ndarjen e mjeteve nga Fondi në ueb faqen e KPM-së jo më vonë se tridhjetë (30) ditësh pas miratimit të vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni.

**NENI 17**  
**KONTRATA MBI GRANTIN PROGRAMOR**

1. Brenda tridhjetë (30) ditësh nga miratimi i vendimit nga neni 16, paragrafi 1, të kësaj Rregulloreje, Kryetari i KPM-së nënshkruan kontratë mbi ndarjen e mjeteve me parashtruesin e kërkesës për grante programore që i kanë përmbushur kushtet për të marr mjete nga Fondi.
2. Kontrata mbi Grantin Programor nga paragrafi 1 i këtij neni gjithashtu përfshin:
  - 2.1 numrin referues të licencës së lëshuar të transmetimit dhe përcaktimin e hapësirës së mbuluar nga programi i OSHMA-së;
  - 2.2 formati dhe një përshkrim i shkurtër i përmbajtjes realizimi dhe transmetimi i së cilës janë objekti i kësaj kontrate (titulli i përmbajtjes, numri dhe kohëzgjatja e emisioneve individuale);
  - 2.3 emri i fushës tematike;
  - 2.4 orari për transmetimin e përmbajtjes;
  - 2.5 shuma e mjeteve të ndara;
  - 2.6 kalendari për disbursimin e mjeteve të ndara në kuadër të thirrjes publike;
  - 2.7 afatet dhe mënyra e raportimit mbi shpenzimin e mjeteve nga Fondi, bashkë me dokumentacionin mbështetës;

- 2.8 kushtet për ndërprerjen e kontratës dhe kthimin e mjeteve;
  - 2.9 detyrimi për mbajtjen e kontabilitetit ndarazi dhe për ndërmarrjen e masave me qëllim të shmangies dhe kthimit të kompensimeve të tepërta;
  - 2.10 afati i kontratës;
  - 2.11 të drejtat dhe detyrimet e tjera.
3. Si pjesë përbërëse, Kontrata mbi Grantin Programor përfshin:
- 3.1 përshkrimin e përmbajtjes të dorëzuar me aplikacionin;
  - 3.2 realizimi i përmbajtjes;
  - 3.3 formularët për raportimin e shpenzimeve të mjeteve nga Fondi.

### **NENI 18 TRANSFERIMI I MJETEVE**

1. Mjetet e ndara në bazë të kontratës nga neni 17 i kësaj Rregulloreje disbursohen sipas kalendarit në vijim:
- 1.1 kësti i parë në vlerë prej 50% të mjeteve të ndara transferohet brenda tri (3) ditësh nga data e nënshkrimit të Kontratës;
  - 1.2 kësti i dytë në vlerë prej 50% të mjeteve të ndara transferohet pas miratimit të raportit të ndërmjetëm mbi shpenzimin e mjeteve nga Fondi.

### **NENI 19 SHPENZIMET E MJETEVE**

1. Mjetet e ndara mund të shpenzohen vetëm:
- 1.1 në pajtim me dispozitat e Kontratës, të kësaj Rregulloreje.
  - 1.2 për të mbuluar kostot që ndërlidhen me realizimin e përmbajtjes që është objekt i kontratës.
  - 1.3 sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, kosto të pranueshme janë kostot si në vijim që janë të përfshira në buxhetin e miratuar:
  - 1.4 kostot lidhur me pagat dhe mëditjet e tjera të llogaritura dhe paguara përpjesëtimisht me aktivitetet e përkufizuara nga kontrata e nënshkruar;

- 1.5 shpenzimet e udhëtimit lidhur me aktivitetet e përkufizuara nga kontrata,
  - 1.6 shpenzimet e përgjithshme (shërbimet e komunalive dhe të telekomunikimit, furnizimet për zyrë dhe të tjera), që nuk tejkalojnë 15% të kostove që ndërlidhen me pagat dhe mëditjet e tjera.
2. Kostot nga paragrafi 2 i këtij neni paguhen para skadimit të kontratës, ku kjo evidentohet me anë të dokumenteve në vijim:
- 2.1 dokumenti mbi formimin e grupit punues të ngarkuar me aktivitetet e përkufizuara me marrëveshjen e nënshkruar;
  - 2.2 kontratat e punës për anëtarët e grupit punues;
  - 2.3 listë-pagesa e vërtetuar;
  - 2.4 vendimi mbi udhëtimin zyrtar;
  - 2.5 urdhri i udhëtimit me dokumentet mbështetëse;
  - 2.6 kopja e pasqyrës së llogarisë nga e cila janë paguar kostot.

## **NENI 20 OBLIGIMET NDAJ PËRFITIMIT TË FONDIT**

1. OSHMA-së së cilës i janë ndarë mjete nga Fondi është i detyruar të mbajë ndarazi kontabilitetin për aktivitetet lidhur me realizimin e përmbajtjes me interes për publikun, gjë që mundëson mbajtjen e llogarive të të ardhurave, shpenzimeve dhe rezultateve afariste lidhur me këtë aktivitet ndarazi nga të ardhurat, shpenzimet dhe rezultatet afariste që lidhen me aktivite të tjera.
2. Programet e mbështetura nga Fondi nuk mund të përdoren për qëllime komerciale.
3. Programet e mbështetura mund të transmetohen edhe nga të licencuarit tjerë të KPM-së pa kompenzim, pas njoftimit paraprak të KPM-së.

## **NENI 21 RAPORTIMI MBI SHPENZIMET E FONDIT**

1. Përfituesi i Fondit është i detyruar t'i dorëzojë raport mbi shpenzimin e mjeteve nga Fondi KPM-së brenda afatit dhe në mënyrën e paraparë me kontratë.
2. Raporti mund të jetë i ndërmjetëm dhe përfundimtar.
3. Raporti i ndërmjetëm dorëzohet pas skadimit të gjysmës së parë të afatit të kontratës.

4. Raporti përfundimtar dorëzohet brenda tridhjetë (30) ditësh nga skadimi i afatit të kontratës.
5. Raporti përbëhet nga:
  - 5.1 raporti programor; dhe
  - 5.2 raporti financiar.
6. Raportet nga paragrafi 5 i këtij neni dorëzohen në formularë të veçantë të ofruar nga KPM dhe të publikuar në ueb faqen e saj.

## **NENI 22 MBAJTJA E ARKIVËS**

1. Përfituesi i Fondit është i detyruar të ruajë të gjitha dokumentet (ato të kontabilitetit, financiare, ligjore, administrative, etj.) dhe të dhënat dhe informatat lidhur me shpenzimin e mbështetjes financiare të ndarë në periudhë prej shtatë (7) vjetësh pas pranimit të pagesës së fundit sipas kontratë mbi ndarjen e mbështetjes financiare.
2. Përfituesi i Fondit është i obliguar që për përmbajtjen e transmetimit të mbajë arkivën e programit të prodhuar dhe t'ia vëjë në dispozicion KPM-së brenda shtatë (7) ditësh pas transmetimit.

## **NENI 23 INFORMACIONET E PËRFITUESËVE TË FONDEVE**

1. Në rastet kur përfituesit e Fondit duhet të zgjasin afatin për përmbushjen e detyrimeve të tyre në kuadër të kontratës pa mjete shtesë, përfituesit e Fondit duhet të marrin pëlqimin me shkrim nga KPM jo më vonë se tridhjetë (30) ditë para skadimit të afatit të paraparë me kontratë.
2. Përfituesi i Fondit ka të drejtë të kërkojë pëlqim për zgjatjen e afatit pa mjete shtesë për përmbushjen e detyrimeve në kuadër të kontratës për më së shumti tre (3) muaj, duke dorëzuar një plan të ri të ekzekutimit.

## **NENI 24 SHKELJA E KONTRATËS**

1. KPM merr vendim për ndërprerjen e kontratës, pas pranimit të dy paralajmërimeve me shkrim, nëse përfituesi i Fondit:
  - 1.1 shkel detyrimet lidhur me dorëzimin e raportit nga neni 21 i kësaj Rregulloreje;
  - 1.2 shkel detyrimet dhe kushtet lidhur me shpenzimin e mjeteve të ndara, siç parashihen me kontratë dhe me këtë Rregullore.

2. Vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni përcakton detyrimin dhe shumën e pjesshme ose të përgjithshme të mjeteve të ndara që përfituesi i Fondit duhet t'ia kthejë Fondit brenda shtatë (7) ditësh nga pranimi i vendimit.
3. Ankesat kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni mund të dorëzohen në KPM brenda afatit tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit.

## **NENI 25 DETYRIMI PËR KTHIMIN E MJETEVE**

1. KPM merr vendim mbi kthimin e mjeteve në rast se:
  - 1.1 Shuma e mjeteve të ndara dhe të transferuara janë më të larta nga sa nevojiten për të mbuluar shpenzimet të një OSHMA-je lidhur me aktivitetet e parapara me kontratën e nënshkruar; apo
  - 1.2 OSHMA-ja ka shpenzuar mbështetjen financiare të ndarë dhe të transferuar duke rënë ndesh me termet dhe kushtet e kontratës së nënshkruar dhe të kësaj Rregulloreje.
2. Vendimi nga paragrafi 1 i këtij neni përcakton detyrimin dhe shumën e mjeteve të ndara të cilat përfituesi i Fondit duhet t'ia kthejë Fondit brenda shtatë (7) ditësh nga pranimi i vendimit.
3. Ankesat kundër vendimit nga paragrafi 1 i këtij neni mund të dorëzohen në KPM brenda afatit tridhjetë (30) ditësh nga pranimi i vendimit.

## **NENI 26 OBLIGIMET**

1. Raporti mbi shpenzimin e mjeteve nga Fondi është pjesë përbërëse e Raportit Vjetor të KPM-së, i cili publikohet në ueb faqen e KPM-së.
2. Mjetet që mbeten të pandara, pas thirrjes publike ose të cilat kthehen, përfshihen në pjesën e Planit Financiar të KPM-së për ciklin e ardhshëm të ndarjes së granteve që ndërlihet me Fondin.

## **NENI 26 HYRJA NË FUQI**

Kjo Rregullore hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

---

**Muja FERATI**  
**Kryetar i KPM-së**

---

**Datë**